



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË



Nr. _____ Prot

Datë ____ .08.2026

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT

Datë 12.08.2026

Drejtuar: Operatorit 2AK Group, NIPT M42626404R si përfaqësues i bashkimit të operatorëve ekonomikë 2AK Group shpk, NIPT M42626404R dhe 2 N shpk, NIPT L31615017L, Adresa: Fier Rruga Kastriot Muco, Lagja 8 shkurti, Nd 66, Fier, 9305

- OE/BOE me nënkontraktor:

PO ☐ JO ☒

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO ☒

Tipi i kontrates: Punë

Lloji i Procedurës së prokurimit: Procedurë e hapur e thjeshtuar

Numri i procedurës: REF-94233-07-22-2026

Përshkrimi i shkurtër i kontratës:

Objekti: Punime mirëmbajtje në Njësitë Administrative dhe rajonet, Bashkia Korçë
Fondi limit: 8.469.678,96 lekë pa tvsh.

Afati: 5 (pesë) muaj nga data e lidhjes së kontratës

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 23.07.2026

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike: Datë 27.07.2026, Nr.47

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. **BO.** 2AK Group shpk, NIPT M42626404R & 2 N shpk, NIPT L31615017L me vlerën:

6.296.840,46 (gjashte milion e dyqind e nentedhjete e gjashte mije e teteqind e dyzet presje dyzet e gjashte) leke pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

2. Shoqëria " VILDEV - CO " shpk, NIPT K83926001F me vlerën:

6.662.781 (gjashte milion e gjashteqind e gjashtedhjete e dy mije e shtateqind e tetedhjete e nje) leke pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

3. Shoqëria OUEN shpk, NIPT K17529215O me vlerën:

6.679.187,46 (gjashte milion e gjashteqind e shtatedhjete e nente mije e njeqind e tetedhjete e shtate presje dyzet e gjashte) lekë pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

4. Shoqëria Gjenerali Shpk, NIPT M42216504H me vlerën:

6.964.342,74 (gjashte milion e nenteqind e gjashtedhjete e kater mije e treqind e dyzet e dy presje shtatedhjete e kater) lekë pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

5. **BO.** AVDOLLI shpk, NIPT K14721001P & NIEM shpk, NIPT K36609610Q me vlerën:

7.253.163,9 (shtate milion e dyqind e pesedhjete e tre mije e njeqind e gjashtedhjete e tre presje nente) lekë pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

6. Shoqëria SARK shpk, NIPT K52531415H me vlerën:

7.286.801 (shtate milion e dyqind e tetedhjetë e gjashtë mijë e teteqind e një) lekë pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

7. Shoqëria ASI INVEST shpk, NIPT M01927023H me vlerën:

7.401.483 (shtate milion e katerqind e një mijë e katerqind e tetedhjetë e tre) leke pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

8. Shoqëria MENI shpk, NIPT J61909018W me vlerën:

7.470.551 (shtate milion e katerqind e shtatedhjetë mijë e peseqind e pesedhjetë e një) lekë pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

9. **BO.** "DOKSANI - G" shpk, NIPT L21809501H & CARA shpk, NIPT K07729920F me vlerën:

7.995.033,36 (shtate milion e nenteqind e nentedhjetë e pese mijë e tridhjetë e tre presje tridhjetë e gjashtë) leke pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nga pjesëmarrësit janë s'kualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Shoqëria OUEN shpk, për arsye:

Gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertës ekonomike të paraqitur nga operatori ekonomik OUEN shpk, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi gabime aritmetike. Në zbatim të pikës 3 të nenit 82 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikohet se: "Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar". Nga verifikimi i preventivit dhe llogaritjeve të ofertës rezultoi se shuma absolute e të gjitha korrigjimeve aritmetike është 1,296,649.50 lekë, ndërsa kufiri maksimal i lejuar prej 2% të vlerës së ofertës ekonomike të ofruar është 133,584 lekë. Për sa më sipër, rezulton se vlera e gabimeve aritmetike tejkalon kufirin prej 2% të vlerës së ofertës ekonomike të ofruar. Në këto kushte, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vendos refuzimin dhe s'kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik OUEN SHPK, për shkak se oferta përmban gabime aritmetike, shuma absolute e korrigjimeve të të cilave tejkalon kufirin ligjor prej

2% të vlerës së ofertës ekonomike të ofruar. Si rrjedhojë, KVO, në zbatim të nenit 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 dhe nenit 82 të VKM nr. 285/2020, s'kualifikon operatorin ekonomik.

2. Bashkimi i operatoreve AVDOLLI shpk & NIEM shpk për arsye:

Gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertës ekonomike të paraqitur nga Bashkimi i operatorëve ekonomikë Avdoli Shpk & Niem Shpk konstatohet se është paraqitur në ofertë një kontratë bashkëpunimi, e cila nuk është nënshkruar nga shoqëria Avdoli Shpk. Në përputhje me nenin 88, të VKM-se 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, bashkimi i operatorëve ekonomikë duhet të paraqesë një kontratë bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve, në të cilën përcaktohet pjesa e punës, që do të realizohet nga secili anëtar i bashkimit. Mungesa e nënshkrimit të njërit prej anëtarëve bën që dokumenti i paraqitur të mos konsiderohet një aktmarrëveshje e vlefshme dhe nuk provon ekzistencën e një marrëveshjeje juridikisht të detyrueshme ndërmjet anëtarëve të bashkimit. Për më tepër, neni 88 parashikon se kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes së secilit anëtar, të përcaktuara në aktmarrëveshjen e bashkëpunimit. Duke qenë se kontrata e bashkëpunimit e paraqitur nuk është e vlefshme për shkak të mungesës së nënshkrimit të shoqërisë Avdoli Shpk, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk është në gjendje të verifikojë dhe vlerësojë ndarjen e pjesëmarrjes së secilit anëtar në kontratë, si dhe përmbushjen e kërkesave ekonomike, financiare, profesionale dhe teknike në raport me përqindjen dhe natyrën e angazhimit të tyre. Si pasojë, nuk mund të verifikohet përmbushja e kërkesave ekonomike dhe financiare, si dhe e kërkesave profesionale dhe teknike, në përputhje me pjesën e angazhimit që i takon secilit operator ekonomik sipas nenit 88 të VKM-se 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar. Për këtë arsye, bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk arrin të provojë përmbushjen e kriterëve të kualifikimit të kërkuara në dokumentet e tenderit. Si rrjedhojë, KVO, në zbatim të nenit 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 dhe nenit 82 të VKM nr. 285/2020, skualifikon operatorin ekonomik

3. Bashkimi i operatoreve "DOKSANI - G" shpk & CARA shpk, për arsye:

Gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertës ekonomike të paraqitur nga Bashkimi i Oepatoreve Ekonomike DOKSANI-G SHPK & CARA SHPK rezulton se, sipas aktmarrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet anëtarëve të bashkimit, operatori ekonomik Doksani-G ka marrë përsipër realizimin në masën 70% të zërave të preventivit të kategorisë “Instalime për Ndriçim”, për objektet nr. 8 dhe nr. 9, konkretisht zërat: F.V. Përçjellës PV-500 Ø 1.5 mm²; F.V. Kutit suport pllaket 2 mod; F.V. Çelës 1 polar 220V 10A; F.V. Ndriçues fluoreshent 1x60W, IP65. Këto punime, referuar natyrës dhe funksionit të tyre teknik, përfshihen në kategorinë e punimeve për të cilat kërkohet licenca profesionale NS-14A “Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni, TV”, sipas kriterit të përcaktuar në pikën 2.2.2 “Kapaciteti profesional” të Dokumenteve të Tenderit. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se operatori ekonomik Doksani-G nuk disponon licencën profesionale NS-14A, megjithëse ka marrë përsipër realizimin e pjesës së punimeve që lidhen drejtpërdrejt me këtë kategori punimesh. Në bazë të nenit 88, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, kërkesat për kualifikim ekonomik, financiar, profesional dhe teknik duhet të përmbushen nga anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Për rrjedhojë, duke qenë se anëtari i bashkimit i cili ka marrë përsipër realizimin e punimeve të kategorisë “Instalime për Ndriçim” nuk plotëson kërkesën për disponimin e licencës profesionale NS-14 A, rezulton se bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk përmbush kriterin e kualifikimit profesional të përcaktuar në Dokumentet e Tenderit. Për sa më sipër, bashkimi i operatorëve ekonomikë skualifikohet, pasi nuk ka provuar përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në pikën 2.2.2 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit. Si rrjedhojë, KVO, në zbatim të nenit 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 dhe nenit 82 të VKM nr. 285/2020, skualifikon operatorin ekonomik.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë ofertuesin 2AK Group shpk, NIPT M42626404R si përfaqësues i bashkimit të operatorëve ekonomikë 2AK Group shpk, NIPT M42626404R dhe 2 N shpk, NIPT L31615017L, Adresa: Fier, Rruga Kastriot Muco, Lagja 8 shkurti, Nd 66, 9305, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 6,296,840.46 (gjashtë milion e dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e teteqind e dyzet presje dyzet e gjashtë) leke pa tvsh, është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
SOTIRAQ FILO